



Kryetari i Komunës

Nr. 01-030/03-0052763-2/26 dt. 15-09-2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 53 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe pas shqyrtimit të Kërkesës nr. 01-030/03-0052763/26 të datës 03.09.2026 për Lejimin e Shpalljes Publike për Financim Publik të OJQ-ve në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për Mbështetje Financiare për Projektet në Sektorin e Kulturës për Thirrjen e Parë Publike për Vitin 2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për Shpalljen e Thirrjes së Parë Publike për Mbështetje Financiare Publike për Projekte/Programet të OJQ-ve në Sektorin e Kulturës për Vitin 2026)

1. **Miratohet** Kërkesa nr. 01-030/03-0052763/26 të datës 03.09.2026 për Lejimin e Shpalljes Publike për Financim Publik të OJQ-ve në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për Mbështetje Financiare për Projektet në Sektorin e Kulturës për Thirrjen e Parë Publike për Vitin 2026, e cila kërkesë pjesë përbërëse ka dhe materialin bazë për Thirrjen Publike.
2. **Lejohet** shfrytëzimi i mjeteve të planifikuara dhe atë në shumën prej 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) Euro ku shuma minimale e aplikimit për Lot 1 është 5,000.00 (pesë mijë) Euro, ndërsa shuma maksimale 15,000.00 (pesëmbëdhjetë mijë) Euro, me shumë totale 15,000.00 (pesëmbëdhjetë mijë) Euro, ndërsa Lot 2 shuma minimale e aplikimit është 2,000.00 (dy mijë) Euro, ndërsa shuma maksimale është 5,000.00 (pesë mijë) Euro, me shumë totale prej 35,000.00 (tridhjetë e pesë mijë) Euro.
3. Për implementimin e Thirrjes Publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF - Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
4. Mbështetja Financiare Publike për Projektet/Programet e OJQ-ve nga paragrafi 1 dhe 2 i dispozitivit të këtij vendimi, do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut, kodi Subvencione dhe Transfere, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Mjetet financiare të cekura në nenin 2 (dy) të këtij Vendimi do të shpërndahen në bazë të Thirrjes Publike për financimin e Projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
6. Dokumentacioni për zbatimin e Thirrjes Publike sipas këtij Vendimi, përfshinë;
 - 6.1. Teksti i Thirrjes Publike;
 - 6.2. Udhëzimet për Aplikantët;
 - 6.3. Formularët e Aplikimit;

- 6.4. Forma për Vlerësimin e Cilësisë së Projekteve;
- 6.5. Format për Raportimin e Zbatimit të Projektit.
7. Formularët e aplikimit të cekur në nenin 5 (pesë) të këtij Vendimi janë;
- 7.1. Forma e Përshkrimit të Programit apo Projektit;
- 7.2. Forma e Buxhetit të Programit apo Projektit;
- 7.3. Forma e Deklarimit të Mungesës së Fondeve të Dyfishta;
- 7.4. Deklarata e Partneritetit (nëse është e aplikueshme);
- 7.5. Forma e Deklaratës së Programeve apo Projekteve të OJQ-ve të Financuara nga Burimet Publike;
- 7.6. Deklarata për Aktivitetet e Kontraktorit të përmendur në përshkrimin e Projektit që janë të njohur me Programin ose Projektin dhe Pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).
8. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në nenin 6 (gjashtë) të këtij Vendimi janë;
- 8.1. Forma e Kontratës për Financimin e Programit apo Projektit;
- 8.2. Formulari për Përgatitjen e Raportit Narrativ për Projektin apo Programin;
- 8.3. Formulari për Përgatitjen e Raportit Financiar të Programit apo Projektit.
9. Thirrja Publike dhe Dokumentacioni për zbatimin e Thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në web faqen e komunës.
10. Në përputhje me Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe udhëzuesit për aplikantët, Kryetari i Komunës do të formojë Komisionin Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve, si dhe për verifikimin e kushteve të përcaktuara me thirrje publike.
11. Komisioni i lartcekur do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit.
12. Komisioni Vlerësues bazë për punën e tij do të ketë Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe Manualin mbi implementimin e kësaj rregulloreje.
13. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është e obliguar të njoftojë përfituesit për kohën dhe datën e nënshkrimit të kontratave.
14. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa
15. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Faton PEÇI

Shtojcë:

Kërkesa nr. 01-030/03-0052763/26 të datës 03.09.2026 e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
Thirrja Publike e DKRS-së me Materialin Përcjellës.

Ti dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- 1x1 Arkivit